



QYTETI I SHKUPIT
Shkup

Në bazë të Nenit 50 paragrafi 1 pika 14 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 5/02) dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 202/24) dhe në lidhje me Nenin 20-g të Ligjit për të Punësuarit në Sektorin Publik ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 27/14, 199/14, 27/16, 35/18 dhe 198/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 143/19 dhe 14/20 dhe 208/24), Qyteti i Shkupit shpall

SHPALLJE PUBLIKE nr. 01/2025
për punësimin e punëtorëve në Qytetin e Shkupit në kohë të pacaktuar

Përcaktohet nevoja për punësimin e punëtorëve në Qytetin e Shkupit në kohë të pacaktuar për vendet e punës të mëposhtme:

1. Emërtimi i vendit të punës **Higjienist/e**, shifra UPR0405A03004, Seksioni për punë ndihmëse, Sektori për punë të përgjithshme, **Numri i përmbauesve (4)**.

Kandidati është e nevojshme t'i plotësojë kushtet e mëposhtme:

Kushte të përgjithshme:

- të jetë nënshkurtas i Republikës së Maqedonisë,
- të përdorë në mënyrë aktive gjuhën maqedonase,
- të jetë në moshë madhore,
- të posedojë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës dhe
- me vendim gjyqësor të formës së prerë të mos i jetë shqiptuar dënim ndalim për kryerjen e profesionit, veprimtarisë apo detyrës.

Kushte të veçanta:

- arsim fillor.
- me ose pa përvojë pune.

Vlera në të holla e pagës bazë neto për vendin e punës Higjienist/e – 42.837 denarë.

Orari i kohës së punës - 8 orë në ditë, 40 orë në javë, nga e hëna deri të premten nga ora 12:30 deri në orën 20:30.

2. Emërtimi i vendit të punës **Shërbëtorë**, shifra UPR0404B02002, Seksioni për punë ndihmëse, Sektori për punë të përgjithshme, **numri i përmbauesve (1)**.

Kandidati është e nevojshme t'i plotësojë kushtet e mëposhtme:

Kushte të përgjithshme:

- të jetë nënshkurtas i Republikës së Maqedonisë,
- të përdorë në mënyrë aktive gjuhën maqedonase,
- të jetë në moshë madhore,
- të posedojë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës dhe

- me vendim gjyqësor të formës së prerë të mos i jetë shqiptuar dënim ndalim për kryerjen e profesionit, veprimtarisë apo detyrës:

Kushte të veçanta:

- arsim fillor
- me ose pa përvojë pune

Vlera në të holla e pagës bazë neto për vendin e punës Shërbëtore - 42.837 denarë.

Orari i kohës së punës - 8 orë në ditë, 40 orë në javë, nga e hëna deri të premten nga ora 8:30 deri në orën 16:30.

3. Emërtimi i vendit të punës **Ekonom, shifra UPR0405A02003, Seksioni për punë ndihmëse, Sektori për punë të përgjithshme, **numri i përmbaruesve (1).****

Kandidati është e nevojshme t'i plotësojë kushtet e mëposhtme:

Kushte të përgjithshme:

- të jetë nënshtetas i Republikës së Maqedonisë,
- të përdorë në mënyrë aktive gjuhën maqedonase,
- të jetë në moshë madhore,
- të posedojë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës dhe
- me vendim gjyqësor të formës së prerë të mos i jetë shqiptuar dënim ndalim për kryerjen e profesionit, veprimtarisë apo detyrës:

Kushte të veçanta:

- Arsim i mesëm gjimnaz ose arsim i mesëm profesional (dega mekanike ose tregtare).
- me ose pa përvojë pune.

Vlera në të holla e pagës bazë neto për vendin e punës Ekonom - 44.650 denarë.

Orari i kohës së punës - 8 orë në ditë, 40 orë në javë, nga e hëna deri të premten nga ora 8:30 deri në orën 16:30.

Kandidatët mund ta shkarkojnë **Aplikimin për punësime për shpalljen publike nr. 01/2025** nga ueb faqja e Qytetit të Shkupit www.skopje.gov.mk ose ta marrin në Arkivin e Qytetit të Shkupit në barakën nr.16 në adresën Bul. Ilinden nr.82, Shkup.

Kandidatët janë të obliguar përveç aplikimit për punësim sipas shpalljes publike nr.01/2025, të depozitojnë edhe biografi të shkurtër dhe letër të shkurtër motivuese, si dhe dëshmi për përmbushjen e kushteve të lartpërmendura në origjinal ose kopje të noterizuara si më poshtë:

- dëshmi për shtetësi;
- dëshmi se me vendim gjyqësor të formës së prerë nuk i është shqiptuar dënim ndalim për kryerjen e profesionit, veprimtarisë apo detyrës;
- dëshmi për përfundimin e nivelit adekuat të arsimit, dhe
- dëshmi për aftësi të përgjithshme shëndetësore.

Kandidatët nëse kanë përvojë pune është e nevojshme të depozitojnë edhe dëshmi për përvojë pune të evidentuar në Agjencinë e Punësimit.

Kandidatët e interesuar dokumentet e kërkuara duhet t'i depozitojnë në Arkivin e Qytetit të Shkupit (baraka nr.16) ose në adresën bul. "Ilinden" nr. 82, Shkup në zarf të mbyllur me shënimin - për **SHPALLJE PUBLIKE nr. 01/2025 dhe numrin rendor të vendit të punës për të cilin kanë aplikuar.**

Afati i aplikimit është 7 ditë pune nga dita e shpalljes së shpalljes publike. Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet e specifikuara në shpallje në momentin e depozitimit të aplikimit.

Vërejtje: Nëse kandidati në aplikim nuk ka dhënë të dhëna për kontakt (numër telefoni ose adresë e-mail) aplikimi do të refuzohet.

Informacion për mënyrën e realizimit të procedurës për përzgjedhjen e kandidatëve për punësim:

Faza 1: verifikimi i aplikimeve dhe dëshmimeve – realizohet në një afat prej 3 ditësh nga dita e përfundimit të shpalljes publike. Nëse mungon ndonjë dëshmi, Komisioni përzgjedhës do të kontaktojë kandidatin nëpërmjet adresës e-mail ose numrit të telefonit në aplikim, dhe ai në një afat prej tri ditësh duhet t'i kompletojë dëshmitë, në të kundërt aplikimi do të refuzohet. Aplikimi do të refuzohet edhe nëse dëshmia/dëshmitë janë të rreme.

Faza 2: intervista me kandidatët që kanë kaluar fazën e parë të përzgjedhjes - realizohet në një afat prej 10 ditësh pas realizimit të fazës së parë të përzgjedhjes.

Fazat e procedurës për përzgjedhje janë rregulluar në mënyrë të hollësishme në **Rregulloren për punësimin e personave ndihmës – teknikë në Qytetin e Shkupit** nr. 08-12594/1 datë 19.11.2024, e cila është shpallur në ueb-faqen e Qytetit të Shkupit (www.skopje.gov.mk).

**QYTETI I SHKUPIT
KRYETARJA E QYTETIT TË SHKUPIT**